



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNËS -MALISHEVË

30.06.2020

01/583

Zyra e Personelit  
Nr.01/  
Më:30/06/2020

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Udhëheqësi Personelit shpall:

**K O N K U R S**  
Për plotësimin e vendit të punës

**I. DREJTORIA PËR ADMINISTRAT TË PERGJITHSHME**

1.(Një) Zyrtar për Arkiv 1

Kualifikimi i kërkuar: Diplomë Universitare Fakulteti i Administratës publike. Fakulteti i Historisë- Arkivistika pa përvojë ose shkollë e larte dhe së paku dy (2) vite përvojë pune nga fushat e lartpërmendura

Koeficienti: 6.

Kodi i vendit të punës AK/150

Numri i referencës: RN00006039

Përshkrimi i detyrave të punës:

- Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;
- Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
- Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
- Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
- Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
- Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
- Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postes shkrësive jashtë dhe brenda institucionit ;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Dokumentet e kërkuara

- Diploma universitare;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- certifikata e lindjes;
- certifikata për trajnimet e kryera;
- Dëshmi qe nuk është nën hetime
- Vërtetimin e përvojës së punës;

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në Zyrën për prirjen e palëve të KK- Malishevë.

Konkursi do të mbetet i hapur 15 ( pesëmbëdhjetë ) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshme: "Epoka e re", në faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelë të shpalljeve të KK- Malishevë.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit  
Gani Bahtjari, jur.dipl.

30.06.2020